

KREU II  
ORIGJINA E MALLRAVE

SEKSIONI 1  
ORIGJINA JOPREFERENCIALE

Neni 59

**Fusha e zbatimit**

Nenet 60 dhe 61 vendosin rregullat për përcaktimin e origjinës jopreferenciale të mallrave për qëllime të zbatimit të:

a) Tarifës Doganore të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të masave të përmendura në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 56;

b) masave të tjera nga masat tarifore, të vendosura nga dispozitat që rregullojnë fusha specifike në lidhje me tregtinë e mallrave;

c) masave të tjera që lidhen me origjinën e mallrave.

Neni 60

**Përftimi i origjinës**

1. Mallrat tërësisht të përftuara në një vend ose territor të vetëm konsiderohen të kenë origjinën e atij vendi ose territori.

2. Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend ose territor, konsiderohen origjinuese në vendin ose territorin ku kanë pësuar ndryshimin ose përpunimin e tyre të fundit, thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit.

Neni 61

**Prova e origjinës**

1. Në rastet kur legjislacioni doganor parashikon se në deklaratat doganore duhet të tregohet origjina e mallrave, autoritetet doganore mund t’i kërkojnë deklaruesit të provojë origjinën e tyre.

2. Në rastet kur legjislacioni doganor, ose kuadri ligjor që rregullon fusha të veçanta, parashikon lëshimin e një prove origjine për mallrat autoritetet doganore, në rast të dyshimeve të arsyeshme, mund të kërkojnë çdo provë shtesë të nevojshme, në mënyrë që të garantojnë se deklarimi i origjinës përputhet me rregullat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.

3. Kur e kërkojnë nevojat e tregtisë, një dokument që vërteton origjinën mund të lëshohet në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me rregullat e origjinës në fuqi në vendin apo territorin e destinacionit ose me çdo metodë tjetër që identifikon vendin ku mallrat janë përftuar tërësisht origjinuese ose kanë pësuar transformimin e fundit thelbësor.

Neni 62

**Aktet nënligjore**

Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen:

a) rregullat, sipas të cilave mallrat, përcaktimi i origjinës jopreferenciale të të cilave kërkohet me qëllim zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 59, konsiderohet se janë tërësisht të përftuara në një vend ose territor apo që kanë pësuar ndryshimin a përpunimin e tyre të fundit thelbësor e të justifikuar ekonomikisht në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e

një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit, sipas përcaktimeve të nenit 60;

b) rregullat procedurale për lëshimin dhe verifikimin e provës së origjinës, sipas përcaktimeve të nenit 61.